

| Emri i Lëndës : Menaxhimi dhe Udhëheqja e Klasës |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                     |                     |                |         |      |
|--------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|---------------------|----------------|---------|------|
| Kodi                                             | Tipi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | Semestri                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | Leksione (orë/javë) | Seminare (orë/javë) | Lab (orë/javë) | Kredite | ECTS |
| EDU 547                                          | B                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | Vjeshtë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 2.00                | 2.00                | 0.00           | 3.00    | 6.00 |
|                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                     |                     |                |         |      |
| Lektori                                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Enriketa Sogutlu, Prof. Asoc. Dr.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                     |                     |                |         |      |
| Asistenti                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                     |                     |                |         |      |
| Gjuha e kursit                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Anglisht                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| Niveli i lëndës                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Master                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                     |                     |                |         |      |
| Përshkrimi                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Kjo lëndë eksploron strategjitë për krijimin e një mjedisi të mirë-menaxhuar në klasë. Studentët do të mësojnë se si të vendosin rregulla dhe procedura efektive, të ruajnë angazhimin e nxënësve dhe adresojnë sjelljen shqetësuese. Lënda thekson rëndësinë e ndërtimit të marrëdhënieve pozitive mësues-nxënës dhe ofron teknika për menaxhimin e kalimeve nga një veprimtari në tjetrën, punës në grup dhe detyrave të pavarura. Përveç kësaj, studentët do të mësojnë strategji për adresimin dhe reduktimin e sjelljeve shqetësuese dhe promovimin e një atmosfere pozitive në klasë. Studentët pritet të fitojnë aftësitë e nevojshme për të krijuar një mjedis mësues mbështetës, për të përmirësuar performancën e nxënësve dhe për të mundur orë mësimore efektive, produktive dhe të rregullta që nxisin suksesin e nxënësve. |                     |                     |                |         |      |
| Objektivat                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Vendosin rregulla dhe procedura efektive, Menaxhojnë sjelljen dhe kalimet në klasë, Ndërtojnë marrëdhënie pozitive me studentët, Krijojnë një mjedis mësues produktiv dhe mbështetës Përdorin në mënyrë efektive punën në grup dhe punën e pavarur                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                     |                     |                |         |      |
| Konceptet Kryesore                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Rregulla dhe procedura Menaxhimi i angazhimit dhe sjelljes së studentëve Marrëdhëniet Pozitive mësues-nxënës Kalimet dhe ndërprerjet e orës së mësimit Përdorimi i materialeve dhe pajisjeve Menaxhimi i punës në grup Aktivitete të pavarura dhe të udhëhequra nga mësuesi Konsistenca në menaxhimin e klasë Roli i familjes në mbarëvajtjen e nxënësit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| Programi i Lëndës                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                     |                     |                |         |      |
| Java                                             | Tema                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                     |                     |                |         |      |
| 1                                                | Hyrje në menaxhimin e klasës: vendosja e rregullave dhe procedurave (fq. 5-9) Kjo javë prezanton bazat e menaxhimit të klasës, duke theksuar rëndësinë e vendosjes së rregullave dhe procedurave të qarta që në fillim. Studentët do të mësojnë se si rregullat e përcaktuara mirë promovojnë një mjedis pozitiv të të mësuarit dhe si t'i zbatojnë dhe komunikojnë ato në mënyrë të vazhdueshme te studentët. Rëndësia e menaxhimit të klasës dhe ndikimi e tij në të nxënit dhe sjelljen e nxënësve. Si ta kuptojmë kornizën për menaxhim efektiv të klasës bazuar në kërkim shkencor dhe praktikat më të mira |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                     |                     |                |         |      |
| 2                                                | Fillimi dhe mbarimi i orës së mësimit ose i ditës (f. 10-18) Menaxhimi i fillimit dhe përfundimit të çdo periudhe mësimi ose dite shkollore është thelbësor për ruajtjen e rendit. Kjo javë trajton strategji për të vendosur rutina të hapjes pa probleme, duke r objektivat dhe siguruar mbyllje efektive me ndërprerje minimale. Si mund të bëhen më efikase kalimet ndërmjet veprimtarive dhe orëve të mësimit.                                                                                                                                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                     |                     |                |         |      |
| 3                                                | Menaxhimi i tranzicioneve dhe ndërprerjeve (fq. 18-21) Kalimet ndërmjet aktiviteteve mund të çojnë në ndërprerje nëse nuk trajtohen në mënyrë efektive. Kjo javë fokusohet në krijimin e tranzicioneve të strukturuar dhe pa probleme, duke minimizuar kohën e humbur dhe reduktimin e ndërprerjeve që mund të ndikojnë negativisht në rrjedhën e orës së mësimit. Do të shqyrtohen gjithashtu teknika se si të menaxhohen ndërprerjet e paparashikuara                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                     |                     |                |         |      |

|           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|-----------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>4</b>  | Përdorimi i materialeve, pajisjeve dhe organizimi i punës në grup (f. 21-31) Menaxhimi i duhur i materialeve dhe pajisjeve të klasës është thelbësor për funksionimin normal të orës së mësimi. Kjo javë diskuton se si të shpërndahen, organizohen dhe mirëmbahen në mënyrë efektive materialet duke siguruar përgjegjësinë e studentëve. Për më tepër, trajtohen strategjitë për menaxhimin efektiv të punës në grup, nga planifikimi deri te ekzekutimi dhe vlerësimi.                                        |
| <b>5</b>  | Puna individuale dhe aktivitete të drejtuara nga mësuesi (f. 31-37) Balancimi i punës dhe aktiviteteve të udhëhequra nga mësuesi mund të optimizojë mësimin. Ky sesion përqendrohet në ruajtjen e angazhimit të studentëve gjatë punës së pavarur dhe krijimin e aktiviteteve dinamike, efektive të udhëhequra nga mësuesi që promovojnë të nxënësit aktiv. Gjithashtu do të trajtohen teknikat për monitorimin e progresit dhe adresimin e sjelljes së padëshiruar që pengon angazhimin në veprimtari.          |
| <b>6</b>  | Disiplina dhe pasojat: Kontroll efektiv në klasë (fq. 37-50) Kjo javë shqyrton qasjet për ruajtjen e disiplinës në klasë. Eksplorohehen lloje të ndryshme pasojash, të cilat përfshijnë shpërblime të prekshme dhe kosto të drejtpërdrejta për sjelljen e keqe. Roli i reagimit të mësuesit ndaj sjelljes së nxënësve dhe strategjitë për zbatimin e rregullave në mënyrë konsistente si pika kryesore në menaxhimin e klasës.                                                                                   |
| <b>7</b>  | Menaxhimi i situatave konkrete në grup dhe përfshirja e familjes (fq. 47-50) Plani i emergjencës mund të jetë shumë efektiv në promovimin e sjelljes pozitive. Kjo javë prezanton konceptin e përdorimit të shpërblimeve dhe ndëshkimeve në grup dhe se si përfshirja e prindërve përmes planeve të emergjencës mund të zgjerojë menaxhimin e sjelljes përtej klasës. Do të hulumtohen strategji për t'i bërë këto plane efektive dhe të drejta.                                                                 |
| <b>8</b>  | Provimi Midterm                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>9</b>  | Marrëdhëniet mësues-nxënës: Ndërtimi i besimit dhe raportit (fq. 56-63) Ndërtimi i marrëdhënieve të forta dhe pozitive me studentët është thelbësor për menaxhimin efektiv të klasës. Kjo javë fokusohet në atë se si të demonstrohet interesi personal për jetën e studentëve, si t'i trajtojmë në mënyrë të barabartë dhe t'u përgjigjemi pozitivisht pyetjeve dhe shqetësimeve të tyre, duke nxitur një atmosferë besimi dhe respekti të ndërsjellë.                                                          |
| <b>10</b> | Marrëdhëniet mësues-nxënës: vetëdija dhe vendosmëria (fq. 64-71) Kjo javë vazhdon temën e marrëdhënieve mësues-nxënës, duke u fokusuar në mënyrën se si mësuesit mund të menaxhojnë me vendosmëri klasat duke iu përgjigjur nevojave individuale të nxënësve të ndryshëm. Rëndësia e vendosjes së kufijve dhe ruajtja e drejtësisë për të siguruar që të gjithë studentët të ndihen të mbështetur dhe të respektuar.                                                                                             |
| <b>11</b> | Mentaliteti i përfshirjes dhe objektivitetit emocional (f. 81-100) Koncepti i "përfshirjes" i referohet vetëdijes së një mësuesi për gjithçka që ndodh në klasë. Kjo temë trajton se si të krijohet qëndrueshmëria dhe si të ruhet objektiviteti emocional dhe qetësia ndërkohë që krijohen situata që të vënë nën presion. Këto aftësi janë me rëndësi kritike për trajtimin e sjelljes së nxënësve përpara se ajo të përshkallëzohet dhe për të ruajtur kontrollin në klasë.                                   |
| <b>12</b> | Inkurajimi i përgjegjësisë dhe zhvillimit personal të nxënësve (fq. 101-113) Inkurajimi i përgjegjësisë është çelësi për nxitjen e nxënësve të pavarur. Kjo temë trajton strategji për promovimin e zhvillimit personal, inkurajimin e nxënësve që të kontrollojnë veprimet e tyre dhe të mbajnë përgjegjësi për to, si dhe t'i udhëzojë ata të marrin vendime të përgjegjshme. Gjithashtu diskutohet edhe se si mund të kultivohet një mjedis ku ushqehet dhe nxitet vetëdisiplina.                             |
| <b>13</b> | Parandalimi dhe zgjidhja e konflikteve në klasë (fq. 113-123) Strategjitë proaktive për parandalimin e konflikteve në klasë, si dhe qasjet efektive për t'i zgjidhur kur ato lindin. Studentët do të mësojnë teknika për zbutjen e konflikteve, lehtësimin e komunikimit dhe përdorimin e praktikave restauruese për të ndërtuar një klimë pozitive në klasë.                                                                                                                                                    |
| <b>14</b> | Fillimi i mirë: Ditët e para të shkollës (f. 132-145) Një fillim i mbarë i vitit shkollor përcakton mënyrën për menaxhim efektiv të klasës gjatë gjithë vitit. Kjo javë trajton se si duhet të përgatitet mësuesi përpara fillimit të shkollës, si të menaxhojë ditën e parë dhe si të veprojë në dy javët e para të cilat janë vendimtare për një vit të mirë akademik. Tematikat përfshijnë vendosjen e pritshmërive, vendosjen e rutinave dhe krijimin e një kulture pozitive në klasë që në fillim të vitit. |
| <b>15</b> | Menaxhimi në rang shkolle: Rregullat, procedurat dhe normat (fq. 152-166) Menaxhimi efektiv i klasës shtrihet përtej klasave individuale në të gjithë shkollën. Kjo temë diskuton se si rregullat dhe procedurat në mbarë shkollën mund të mbështesin një klimë pozitive të shkollës dhe krijimin e një kulture të tillë. Shqyrtimi i strategjive për vendosjen e normave të sjelljes dhe se si konsistenca në zbatimin e rregullave sjell dobi për studentët, mësuesit dhe mjedisin e përgjithshëm të shkollës. |

|                                            |                                                                                                                                                                                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|--------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>16</b>                                  | Provim Final                                                                                                                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|                                            | <b>Parakushtet</b>                                                                                                                                                                                                             | Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|                                            | <b>Literatura</b>                                                                                                                                                                                                              | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sabornie, E. J., &amp; Espelage, D. L. (Eds.). (2023). Handbook of classroom management. Routledge, Taylor &amp; Francis Group.</li> <li>• Jones, V., &amp; Jones, L. (2021). Comprehensive classroom management: Creating communities of support and solving problems (12th ed.). Pearson</li> </ul> |
|                                            | <b>Referenca të tjera</b>                                                                                                                                                                                                      | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Musai, B. (2015). Metodologji e Mësimdhënies. shtëpia Botuese Pegi, tiranë</li> <li>• Borich, G. (2017). Effective Teaching Methods (9th edition). Pearson</li> </ul>                                                                                                                                 |
| <b>Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat</b> |                                                                                                                                                                                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>1</b>                                   | Studentët do të jenë në gjendje të krijojnë dhe zbatojnë rregulla dhe procedura të qarta dhe efektive në klasë që nxisin një mjedis mësimor produktiv.                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>2</b>                                   | Studentët do të demonstrojnë aftësinë për të menaxhuar në mënyrë efikase kalimet ndërmjet aktiviteteve dhe përdorimin e materialeve dhe pajisjeve për të minimizuar ndërprerjet dhe për të maksimizuar kohën e të mësuarit.    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>3</b>                                   | Studentët do të aplikojnë strategji të ndryshme disiplinore, duke përfshirë planet e emergjencës në grup për të mbajtur kontrollin në klasë duke promovuar sjellje pozitive të nxënësve.                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>4</b>                                   | Studentët do të kuptojnë dhe zbatojnë strategji për të ndërtuar marrëdhënie pozitive dhe besimi me nxënësit, duke përfshirë demonstrimin e interesimit, trajtimin në mënyrë të barabartë dhe adresimin e nevojave individuale. |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>5</b>                                   | Studentët do të zhvillojnë teknika për të inkurajuar përgjegjësinë dhe zhvillimin personal të nxënësve, duke u i mësuar dhe ndihmuar të mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe vendimet e tyre në klasë.                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>6</b>                                   | Studentët do të përdorin strategji proaktive për të parandaluar konfliktet dhe për të zgjidhur në mënyrë efektive mosmarrëveshjet në klasë, duke nxitur një mjedis mësimor pozitiv dhe gjithëpërfshirës për të gjithë.         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |

| Mënyra e Vlerësimit të Lëndës                                                            |       |                   |                       |
|------------------------------------------------------------------------------------------|-------|-------------------|-----------------------|
| Notat e Ndërmjetme                                                                       | Sasia | Përqindja         |                       |
| Gjysmë finale                                                                            | 1     | 30                |                       |
| Kuize                                                                                    | 0     | 0                 |                       |
| Projekte                                                                                 | 1     | 20                |                       |
| Projekte semestrale                                                                      | 0     | 0                 |                       |
| Punë laborator                                                                           | 0     | 0                 |                       |
| Pjesëmarrja në mësim                                                                     | 0     | 0                 |                       |
| Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final                                   |       |                   | 50                    |
| Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final                                         |       |                   | 50                    |
| Total                                                                                    |       |                   | 100                   |
| Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)                                        |       |                   |                       |
| Aktivitetet                                                                              | Sasia | Kohëzgjatja (orë) | Ngarkesa Totale (orë) |
| Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit) | 16    | 4                 | 64                    |
| Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)                              | 14    | 3                 | 42                    |
| Detyra                                                                                   | 1     | 10                | 10                    |
| Gjysmë finale                                                                            | 1     | 15                | 15                    |
| Provimi final                                                                            | 1     | 20                | 20                    |
| Të tjera                                                                                 | 0     | 0                 | 0                     |
| Ngarkesa totale e orëve                                                                  |       |                   | 151                   |
| Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)                                                       |       |                   | 6.04                  |
| ECTS                                                                                     |       |                   | 6.00                  |